



Datë: 22.05.2025
Numër Protokolli: 4542/2025

A.nr.559/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.559/2025, të datës 27.03.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.E, me objekt ankese “*kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.559/2025, e datës 27.03.2025, e parashtruar nga ankuesi Sh.E.

II. Mbeten në fuqi Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin, të datës 25.02.2025 dhe 27.02.2025.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Sh.E (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 26.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 27.03.2025, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa, ky i fundit, më datë 15.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2063/2025, të datës 27.03.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.02.2025 dhe 27.02.2025; Opinionin nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, i datës 11.09.2024 dhe 07.03.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin A.nr.281/2025 të KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.04.2025; Akt Emërimit e datës 27.05.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor Hetues i konkurrencës; Vendimin

me Nr. 50.2023 i datës 16.05.2023; Vendimin me Nr.16/24 i datës 14.02.2024; Emailin e datës 03.02.2025 dhe 24.02.2025 nga I.Z; Akt Emërimit e datës 19.12.2023 për S.B; Emailin e datës 25.03.2024, 17.04.2024, 23.04.2024, 10.05.2024 nga S.B për ankuesin; Emailin e datës 18.06.2024 nga S.B për ankuesin, R.A, A.Gj, M.M, A.R dhe E.B; Emaili i datës 20.06.2024 nga S.B për ankuesin dhe I.Z; Emailin e datës 24.06.2024 nga S.B për ankuesin dhe të tjerët; Emailin e datës 01.07.2024 nga S.B për E.B dhe të tjerët përfshirë edhe ankuesin; Emailin e datës 04.07.2024 nga S.B për R.A dhe E.B; Emailin e datës 03.07.2024 nga E.B për S.B; Emailin e datës 15.07.2024 nga S.B për ankuesin; SIMBNJ dhe I.Z; Emailin e datës 15.07.2024 nga S.B për ankuesin dhe E.T; Emailin e datës 15.07.2024 nga E.T për N.B dhe S.B; Emailin e datës 19.07.2024 nga S.B për ankuesin; Emailat e datës 22.07.2024,19.07.2024, 22.07.2024,19.07.2024, 29.07.2024, 23.09.2024, 09.10.2024, 19.07.2024, 01.11.20024 nga S.B për ankuesin; Emailin e datës 22.10.2024 nga S.B për N.B dhe të tjerët; Emailin e datës 29.11.2024 dhe 22.11.2024 nga S.B për E.T, A.R dhe ankuesin; Emailin e datës 17.04.2024 nga S.B për ankuesin; Emailin e datës 30.01.2024 dhe 29.01.2024 nga S.B për ankuesin, A.Gj dhe R.A; Emailin e datës 30.01.2024 nga ankuesi për S.B; Emailin e datës 26.01.2023 nga F.R për S.B; Emailin e datës 23.11.2023 nga J.M për S.B dhe B.B; Emailin e datës 29.01.2024, 18.01.2024 nga S.B për ankuesin, R.A, E.T dhe A.Gj; Emailin e datës 05.01.2024 nga N.B për S.B; Emailin e datës 26.12.2023 nga Info Konkurrenca për ankuesin etj; Emailin e datës 26.12.2023 nga TEB Banka; Emailin e datës 05.09.2024 nga A.R për ankuesin , R.A, F.Z dhe E.S; Emailin e datës 04.09.2024, 03.09.2024 nga ankuesi për R.A, F.A dhe E.Z; Emailin e datës 03.09.2024 nga R.A; Emailin e datës 28.08.2024 nga A.R për ankuesin dhe F.Z; Emailin e datës 28.08.2024 nga A.R për ankuesin; Emailin e datës 25.08.2024 nga .S për A.R; Emailin e datës 15.04.2025 nga ankuesi për E.T; Emailin e datës 15.04.2025 na A.R për ankuesin; Emailin e datës 11.04.2025 nga ankuesi për A.R; Emailin e datës 27.02.2025 nga A.R për ankuesin; Vendimin me numër protokolli 3035/2025 të datës 06.05.2025 për shtytje të afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 106/13, të datës 17.05.2013, mbanë pozitën e punës *Inspektor për Hetimet e Shkeljeve të Konkurrencës në Treg*, në Autoritetin e Konkurrencës (tutje AKK), ndërsa, sipas Vendimit me Nr. 50/2023 të datës 16.05.2023, i njëjti është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 14.02.2024.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në cilësi të mbikëqyrësit në raport më ankuesin, më datë 25.02.2025, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 01.01.2024 deri 14.02.2024, gjegjësisht, lidhur me periudhën ku ankuesi ka ushtruar pozitën e Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut dhe atë me nivel të përgjithshëm të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”. Me konkret, lidhur më objektiven nr. 1: Mbikëqyrë, monitoron dhe heton tregjet në Kosovë, është vlerësuar më nivelin “*Ka nevojë për përmirësim*, ndërsa, lidhur me objektivin nr.2: Mbikëqyrë dhe koordinon hetimet ndaj bizneseve dhe objektiven nr.3: Mbikëqyrë punën e vartëse të tij në hetimin e tregjeve, parandalimin ose zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara, vlerësimin e përqendrimeve dhe ose abuzimin në pozitën dominuese, është vlerësuar me nivelin “*E papranueshëm*”, kurse, lidhur me pjesën e aftësive profesionale sipas pikave 1.1 –aftësitë analitike, 1.2 -iniciativa dhe kreativiteti, 1.5-adoptimi dhe fleksibiliteti, është vlerësuar më nivelin “*ka nevojë për përmirësim*” , kurse, lidhur me aftësitë 1.3-Komunikimi efektiv, 1.4-bashkëpunimi dhe puna në ekip, 1.6- respektimi i rregullave dhe procedurave dhe IV. Vlerësimi i aftësive metodologjike, personale dhe sociale, është vlerësuar më nivelim “*e papranueshme*”.

Me tej, ankuesi, po më datë 25.02.2025, është vlerësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së për periudhën 14.02.2024 deri më datë 31.07.2024, për pozitën inspektor hetues në Divizionin për Marrëveshje të Ndaluar, dhe atë më nivelit të përgjithshëm të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”, gjegjësisht, lidhur me objektivin nr.1: Monitorimi i Tregut të Kosovës në fushën e konkurrencës dhe analiza e tregut, është vlerësuar më nivelin “*arrin pritshmërinë*”, lidhur me objektiven nr.2: Hetimi i shkelje të konkurrencës në treg/marrëveshjet e ndaluar dhe objektiven nr.3: Vlerësimi i abuzimit më pozite dominuese, është vlerësuar më nivelin “*ka nevojë për përmirësim*”, kurse, lidhur me pjesën e aftësive profesionale sipas pikave 1.1-aftësitë analitike, 1.2-iniciativa dhe kreativiteti, 1.5-adoptimi dhe fleksibiliteti, është vlerësuar më “*ka nevojë për përmirësim*”, kurse, lidhur me aftësitë 1.3-Komunikimi efektiv, 1.4-bashkëpunimi dhe puna në ekip, 1.6- respektimi i rregullave dhe procedurave, dhe IV.- Vlerësimi i aftësive metodologjike, personale dhe sociale, është vlerësuar më nivelin “*e papranueshme*”.

Tutje, me datë 27.02.2025, Udhëheqësi i Divizionit për Marrëveshje të ndaluar, po në cilësinë e mbikëqyrësit të ankuesit, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin dhe atë për periudhën 01.08.2024 deri më datën 31.12.2024, më nivel të përgjithshëm të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, është tendencioze dhe aspak objektiv. Shton së Udhëheqësi i Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar është i ndikuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Kryetarja e Bordit. Kërkon që të aprovet ankesa dhe të anulohen në tërësi vlerësimet e bëra nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankueses konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 127, paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referuar bazës ligjore në fuqi që rregullon çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë, gjegjësisht Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 52, me të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë*

përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përynjatimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme....”

Rrjedhimisht, në vështrim të kuadrit ligjor si më sipër Kolegji ka analizuar aktet e kontestuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë erdhi në përfundimin së ankuesi më asnjë provë nuk ka rritur të argumentoj pretendimet e tij lidhur me vlerësimin jo të drejtë dhe tendencioze të rezultateve në punë për vitin 2024, e në veçanti ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka ofruar dëshmi që provojnë rrethanat së i njëjti ka përmbushur objektivat e punës, si për pozitën e punës së Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut, ashtu, edhe të inspektorit hetues. Në kontekst të kësaj, Kolegji thekson faktin se ankuesi nuk posedon si provë asnjë raport të punës apo dëshmi lidhur me realizimin e aktiviteteve të punës si objekt i vlerësimit të kontestuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur së Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, si epror i ankuesit, ka adresuar disa emaila ndaj ankuesit, lidhur me mos respektim të orarit të punës, refuzimin e kërkesave të Drejtorit të Përgjithshëm siç është rasti i refuzimit të pjesëmarrjes në trajnimin e organizuar nga RCC dhe pjesëmarrjes në grupe punuese, mos dërgim i raporteve të punës, si dhe mos përmbushje të detyrave të punës, gjegjësisht mos dërgim i raporteve hetimor lidhur me subjektet Iber Lepnc, KEDS, KESCO, Çerdheve...

Andaj, në kuptim të gjendjes së fakteve të evidentuar si më lartë dhe duke qenë së ankuesi nuk ka arritur të argumentoj pretendimet e tij ankimore, atëherë, Kolegji i Këshillit konstaton së ankesa është e pabazuar dhe për rrjedhojë vlerësimi rezultateve në punë për ankuesin lidhur me vitin 2024 është i drejtë, kështu që, mbi këtë bazë, aktet e kontestuar janë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Për sa më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të LPPA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.559/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Sh.E;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.